

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Trajnime të ndryshme”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79632000-3;

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,441,650 (një milion e katërqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, i ndarë në tre lote si vijon:

LOTI 1- me objekt: “Trajnimi dhe certifikimi i personelit për punët në impjante elektrike dhe për punimet me enët nën presion me fond limit 657,950 (gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh;

LOTI 2- me objekt: “Trajnimi dhe certifikimi i personelit për mbrojtjen ndaj zjarrit” me fond limit 416,500 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh

LOTI 3- me objekt: “Trajnimi dhe certifikimi i personelit për atmosferat Shperthyese dhe pajisjet mbrojtese (ATEX)” me fond limit 367,200 (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT janë të njëjta për të III Lotet përkatësisht:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të lotit perkatës, apo shumatores së fondit limit të të tre loteve për të cilat oferton.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës të fondit limit të lotit perkatës, apo shumatores së fondit limit të të tre loteve për të cilat oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që

AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenet e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet paraqesë Licencën/autorizim, Kodi X.2.B të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) ose nga cdo autoritet tjetër që janë ekuivalent me to (Me emertim pershkrues veprimtarie te ngjashem me objektin prokurimit).

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Shërbimi i trajnimit nuk mund të ofrohet nga çdo subjekt tregtar por vetëm nga ato subjekte që janë të licensuara/autorizuara nga institucionet kompetente ndaj duke qenë se është në proporcion me objektin e prokurimit të kësaj procedure vlerësojmë që operatorët ekonomikë ta disponojnë këtë dokument.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara ne Kodin e Etikes te AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit te kesaj kontrate. (ky kod eshte i publikuar në SPE se bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t'i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të

bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t'i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara ne Kodin e Etikës të AGS SHA qe kane lidhje me realizimin e objektit te kësaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën e shërbimit dhe afatin kohor për realizimin e këtij trajnimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.